

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“Himara Hotel” Shpk

Sot, më datë 14.04.2025 ne të poshtëshënuarit:

Shoqëria BEGA-07, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K73312401J, me adresë Lagjja "16 Prilli", Rruga Leon Rei", Pallati Bega-07, Prane Stadiumit " Loni Papuçiu", përfaqësuar nga Administratori Arben Muçobega, atësia Sadik, amësia Zengjine, shtetas Shqiptar, lindur në Kamçisht, Tepelenë dhe banues në TIRANË, me adresë Muharrem Butka; Nd. 5; H. 2; Ap. 27; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 23/06/1973, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035044594 dhe nr. personal H306230160

Të cilet në respektim të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, “ Për Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare “, i ndryshuar me ligjin 129/2014, ligjit 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, hartoi aktin e themelimit, te shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emertimin “Himara Hotel” Shpk (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është **“Himara Hotel” Shpk**

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën : “Fier Lagjja "16 Prilli", Rruga Leon Rei", Pallati Bega-07, prane stadiumit " Loni Papuçiu" Fier

Neni 3

- 3.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.
- 3.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4

4.1. Objekti i Shoqërisë është:

- Hoteleri, Restorant, Bar kafe.
- Zhvillimi e veprimtarive ne fushen e turizmit, pergatitja e guidave, tour operator.

Objekti i veprimtarise te shoqerise mund te ndryshohet, perditesohet, plotesohet ne çdo moment me vendim te Asamblesë .

- 4.2. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.
- 4.3. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërie, objekt që ajo e vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.
- 4.4. Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti që ka lidhje me objektin e saj.

Neni 5

- 5.1. Kapitali i Shoqërisë është 100 000 (njëqint mijë) lekë.

Shoqëria Bega 07 shpk do të zotëroj 100% të kuotave të kapitalit

- 5.2. Kapitali përbehet nga 1 njësi kuote e barabartë me 100 000 Leke.

Neni 6

- 6.1. Derdhja e kuotave të kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e sipërpermendur:
- 6.1. Sipas kontributeve të cituara:

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara nga neni 12 i Statutit.

Neni 8

- 8.1. Shoqëria administrohet nga administratori. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 8.2. **Nëpërmjet këtij akti, emërohet Administrator Z. Muharrem Muçobega**
- 8.3. Administratori kanë të drejtë të veprojnë, personalisht ose duke i deleguar personave të tretë tagrat e administratimit në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, lidhur me të gjitha procedurat për regjistrimin e Shoqërisë si person juridik pranë organit kompetent. Ata veprojnë për llogari të Shoqërisë deri sa regjistrimi i saj të ketë përfunduar.
- 8.4. Administratori i sipërpërmendur i jepen të gjitha të drejtat e administrimit, të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe ekzekutimin e të gjitha akteve në emër dhe për llogari të Shoqërisë dhe ata mund të delegojnë përgjegjësitë tek persona të tretë, me prokurë të posaçme. Afati i Administratorit emërohet për një afat prej (5) vjet.

Neni 9

- 9.1. Çdo mosmarrëveshje që lind me Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 9.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

Lexuar, nënshkruar

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISË
“HIMARA HOTEL” SHPK**

Shoqeria Bega 07 shpk përfaqësoar nga Administratori Arben Muçobega

Arben Muçobega



[Signature]